



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/323](tel:+35542380300323)

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I59-2 Prot.

Tiranë
18/_12_/2025

Nr. Dok. 202503109/2

Lënda: Mbi inspektimin e kryer në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Kukës

Drejtuar: Z. Loard Sollaku
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

KUKES

Z. Besmir Qibini
Shef i Komisarariatit të Policisë

KUKËS

Për dijeni: Z Drejtues Madhor Ilir PRODA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në Komisarariatit të Policisë Kukës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (**MKPT**), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu këtë inspektim në Komisarariatit të Policisë në Kukës, në datë 18.07.2025, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Vullnet Topalli, znj Nertila Qafëzezi, znj. Lindita Dedëgjoni dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar. Inspektimi ishte pa palajmëruar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, dhe Urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me z. Loard Sollaku, Drejtor dhe z. Agim Koçiraj, Zëvendës drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, Drejtori dhe Zëvendës drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, Kukës informoi grupin e inspektimit për gjendjen në të cilën ndodhen ambientet e sigurisë dhe të shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë që kryejnë detyrën në këto ambiente, për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i monitorimit i shoqëruar nga Zv.Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, inspektoi në vend gjendjen e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilat janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimin e kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve e ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/arrestuar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona. Punonjësit e policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit në ambientet e këtij komisariati.

Nga verifikimi i masave për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e kryer në datë 05.07.2024, rezultoi se:

1. ***Ishte zbatuar rekomandimi*** për konsultim me Dhomën e Avokatëve për t'u siguruar që avokatëve kryesisht t'u kujtohet roli i tyre kyç për të qenë të pranishëm në komisariatit e policisë Kukës dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë.
2. ***Ishte zbatuar rekomandimi*** për vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar, brenda ambienteve të dhomave të shoqërimit pasi përgjatë kalimit në korridor nuk garantohet leximi dhe kuptimi i tyre nga të shoqëruarit.
3. ***Ishte zbatuar rekomandimi*** për krijimin në ambientin e sigurisë të një dhome të veçantë, që të shërbejë si ambient ajrimi për personat e arrestuar/ndaluar.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk ishin zbatuar rekomandimet e mëposhtme:

4. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi*** për krijimin në ambientin e shoqërimit të Komisarariatit Kukës të një dhome shoqërimi për të miturit në konflikt me ligjin, e cila të jetë e ndarë më vete nga dhomat e shoqërimit për personat e rritur dhe për gra, sikurse përcaktohet në dispozitat e Kodit Penal për të Mitur dhe në procedurën standarde: "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit".
5. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi*** për krijimin në ambientin e shoqërimit të një dhome për marrjen në pyetje të të shoqëruarve (të arrestuar në flagrancë), para se të kalojnë në dhomat e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me video dhe audio në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin e të ndaluar/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore, që ndodhet në ambientet e sigurisë të këtij komisariati.
6. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi***, për plotësimin e regjistrit të kërkesë/ankesave në çdo rast kur ka kërkesa apo ankesa nga personat e privuar nga liria në këtë komisariat.
7. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi*** për organizimin e trajnimeve me punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit dhe dhomat e sigurisë.
8. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi*** për evidentimin në kartën e të drejtave të afatit maksimal deri në 5 orë të ndalimit të përkohshëm në ambientet policore të shtetasve të shoqëruar.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësia vendore, por çdo komisariat duhet të demonstrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve, por kontatojme se disa të tjera lidhen me qasjen bashkëpunuese të Drejtuesve të Policisë ndaj rekomandimeve, ndonëse të pranuar dhe të përsëritura disa herë nga ana jonë. Ndërkohë ka edhe rekomandime që kanë ndikim të qenësishëm në jetën e të shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve të cilat nuk kanë asnjë implikim buxhetor, dhe për pasojë moszbatimi i këtyre të fundit është i pajustificueshëm.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se në ambientet e Komisarariatit të Policisë Kukës, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kukës, nuk është i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të mbajtjes dhe qëndrimit të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022¹, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Godina e ambientit të shoqërimit është e ndarë nga godina kryesore e drejtorisë dhe komisarariatit të policisë. Në këtë mjedis ndodhen 2 (dy) dhoma shoqërimi, për mbajtjen dhe qëndrimin e meshkujve, ndërsa dhoma tjetër përdorej për mbajtjen dhe qëndrimin e grave dhe të miturve në konflikt me ligjin. Dhomat e shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin ulur të personave, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me orëditë e nevojshme, si 1 (një) stol dhe 2 (dy) karrige të reja, të fiksuara në dysHEME në mënyrë të palëvizshme, por mungonte tavolina sikurse përcaktohet në procedurat standarde². Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa 4x3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur për 4 persona, për secilën dhomë.

Mungesa e dhomës së shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin është një nga problematikat që paraqitet në këtë komisarjat, duke sjellë si pasojë mos garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike, profesionale dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Dhoma e shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ishte ndërtuar siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, me ujë të rrjedhshëm 24 orë dhe të pajisura me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

¹ Kreu VI, pika 4 gërmat b dhe c “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

² Kreu VI, pika 4/f.1 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Në ambientin e shoqërimit, ndodhet dhoma për njohjen e personit e përbërë nga dy dhoma që ndahen në mes me xham pasqyrë, e cila përdoret nga oficerët e policisë gjyqësore për identifikimin dhe njohjen e personit, në rastet kur ai dyshohet për kryerjen e një veprë penale.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë më vete **të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/marrjen në pyetje nga punonjësit e policisë, të personave të shoqëruar, për të cilët ekzistojnë kushtet** e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Sa më sipër, çon në shkelje të të drejtave të tyre sipas parashikimeve të Urdhrit të Drejtorit të Policisë Nr. 894, datë 19.07.2022 “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se: *“Personat e shoqëruar deri në sqarimin e pozitës dhe të arsyes së shoqërimit mbahen në ruajtje dhe monitorim të punonjësit të policisë të funksionit të caktuar ose me mjete të tjera digjitale (sisteme të kamerave video – audio).*

Sipas strukturës, Komisariati i Policisë Kukës kishte në organikë 4 specialistë policie/OPGJ dhe 12 specialistë SPZ. Nga këqyrja e zyrave të specialistëve të policisë/OPGJ dhe ndihmës/specialistëve të policisë/SPZ, nuk u gjetën sende apo mjete, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje në zyrat e tyre.

Në Komisarlatin e Policisë Kukës mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale, dhe në mungesë të saj oficerët e Policisë Gjyqësore, me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre³.

Në ambientin jashtë dhomave të shoqërimit, në korridore dhe në dhomat e shoqërimit ishin të afishuara posterat me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit. Përgjatë inspektimit konstatuam se në zyrën e informacionit mungonin kartat e të drejtave të printuara, në të cilën duhet të jetë e evidentuar dhe e drejta e afatit maksimal deri në 5 orë të ndalimit të përkohshëm në ambientet policore të shtetasve të shoqëruar.

Në ligjin e ri për Policinë e Shtetit nr. 82/2024, neni 20 “Ndalimi i përkohshëm policor”, pika 3, “ndalimi i përkohshëm policor duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 5 orë”. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson uljen e kohës së ndalimit të përkohshëm, i cili fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes, por në asnjë rast jo më shumë se 5 orë. Sipas informacionit të marrë nga drejtuesit e institucionit të gjithë personat në konflikt me ligjin të shoqëruar në komisarlat, ishin njohur me të drejtat e tyre dhe afatet e parashikuara ligjore.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë⁴. Sa më sipër, Avokati i Popullit inkurajon

³ Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale “Vulosja e sendeve të sekuestruara”.

⁴ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti

pajisjen e qytetarëve me “Kartën e të drejtave” në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisariat policie. Nëpërmjet “Kartës së të drejtave” qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të “Kartës së të Drejtave” është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Gjithashtu edhe Komiteti për parandalimin e torturës CPT-ja, përshëndeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimi të sigurohen që të shoqëruarit që shkruajnë e lexojnë, e kuptojnë përmbajtjen e kartës së të drejtave.

Në koridoret e dhomave të shoqërimit ishin të instaluar 2 kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti, por ato mungonin brenda dhomave të shoqërimit për monitorimin e personave të shoqëruar në këtë insitucion. Instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë brenda dhomave të shoqërimit do të shërbejë për mbajtjen në vëzhgim të dhomave të shoqërimit, si dhe do të monitorojë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimit në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre. Sistemi i kamerave administrohej nga salla operative në DVP Kukës, ndërsa pamjet filmike ruheshin deri në 30 ditë.

Në kushtet e vendndodhjes së komisariatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, ku thuhet se: “*Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshijë tualetin) si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridorit të tyre dhe pjesen e jashtme të dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit DPV komisaritate, stacione policie*”.

Në Komisaratin e Policisë Kukës gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **17.07.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **231** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku saktësisht ishin të shoqëruar **222** shtetas madhorë burra, 4 gra dhe 5 të mitur në konflikt me ligjin. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

Gjatë inspektimit u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit Nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Më tej, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë Kukës, ishte përgjithësisht i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Ambienti i sigurisë ka 6 (gjashtë) dhoma sigurie, të cilat ndahen në 4 (katër) dhoma për personat arrestuar/ndaluar për të rritur, dhe 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë është për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e 8 (tetë) personave të ndaluar/arrestuar. Në dhomat e sigurisë të komisarariatit Policisë Kukës, mbahen dhe personat e arrestuar apo të ndaluar nga Komisarartet e Policisë Has dhe Tropojë. Nisur nga numri i veprave penale të kryera dhe numri i shtretërve, dhomat e sigurisë në Komisaratin e Policisë në Kukës kanë kapacitete të mjaftueshme për mbajtjen dhe sigurimin e personave të arrestuar/të ndaluar nga të dy komisarartet e policisë Kukës dhe Has.

Dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara sipas normave dhe parametrave të përcaktuara në procedurën standarde, të ndara në dhomë dhe paradhomë, me një skarë hekuri dhe derë në mes të saj. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësore për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².

Dhoma për fjetje ishte e pajisur me krevatin me elemente hekuri (dy nga dhomat kishin 2 krevate), WC e fiksuar në mënyrë të pa çmontueshme pa depozitën e ujit, si dhe buton zile/sinjali e montuar në mur, e cila ishte funksionale, për kontakt me punonjësin e shërbimit në rast nevojë. Ato ishin gjithashtu të kompletuara me dyshekë, batanije dhe jastëk për fjetje. Ndërsa në paradhomë, ishin të vendosura dhe të instaluar pajisjet për mbajtjen e higjienës personale si lavaman me rubinetin e ujit, depozitë uji për WC-në, pajisje elektrike si çelës dhe llampa për ndriçim të përshtatshëm të paradhomës e dhomës së qëndrimit, si dhe një pajisje për ngrohje qëndrore gjatë dimrit.

Koha e qëndrimit të personave arrestuar/ndaluar në ambientin e sigurisë, ishte brenda afatit 96 orë të përcaktuar Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa, për periudhën janar - korrik 2025, në regjistër u evidentuan të regjistruar 95 persona të ndaluar/arrestuar, nga të cilët 94 burra, 1 grua dhe asnjë i mitur. Nga verifikimi i këtij regjistri, në periudha të ndryshme kohore, nuk u evidentuan raste të mbipopullimit në dhomat e sigurisë.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Gjithashtu, dhomat kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Ambienti i sigurisë ishte i lyer dhe i pastër nga ana higjieno-sanitare.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej:

- i) zyra e përgjegjës të dhomave të sigurisë;
- ii) dhoma për marrjen në pyetje të të arrestuarve nga përfaqësuesi i organit të akuzës dhe për takime me avokatin mbrojtës; si dhe, dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore.

Në korridor ndodhej dhe një aparat telefoni fiks, për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Në dhomën e përgjegjës të dhomave të sigurisë, mbahen nën administrim regjistrat për evidentimin e të dhënave dhe aktivitetin që zhvillohen me personat e ndaluar/arrestuar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde. Theksojmë se këto regjistra ishin mbajtur në mënyrë korrekte dhe konkretisht; i) regjistri për evidentimin e personave të arrestuar/ndaluar; ii) regjistri i sendeve personale; iii) regjistri i marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore; iv) regjistri i takimeve me mbrojtësit ligjorë (avokatë e kujdestarë), mbrojtësit e të drejtave të njeriut Avokatin e Popullit, OJF etj.; v) regjistri i evidentimit të vizitës mjekësore që kryhet menjëherë pas arrestimit/ndalimit dhe vizitat mjekësore që kryhen në qendrat spitalore; vi) regjistri i kërkesë/ankesave, etj. Të gjithë regjistrat ishin të sekretuar me vulë nga sekretaria e institucionit.

Dhoma e marrjes në pyetje të personave të arrestuar ishte e pajisur me karrige për qëndrimin ulur dhe tavolinë pune, të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme. Punonjësit e policisë gjyqësore apo prokurori, prezantoheshin para se të kryenin veprimet procedurale me personat e arrestuar apo të ndaluar.

Kjo dhomë **nuk** është e pajisur me sistemin e kamerave audio – vizive, për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore që kryhen me të arrestuarit/ndaluarit. Ky ambient shërbente njëkohësisht edhe si dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët mbrojtës, të cilat realizoheshin sa herë kërkohej nga ana e tyre.

Avokati i Popullit kërkon regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese

elektronike (audio dhe/video). Duhet të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.

Po ashtu, dhe CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar⁵

Gjithashtu, dhoma e mjekut ishte e pajisur me orenditë dhe pajisjet e nevojshme, si tavolinë pune e mjekut e fiksuar në dysheme në mënyrë të pa lëvizshme, karrige pune, një kasafortë e mbyllur me çelës për mbajtjen e medikamenteve mjekësore dhe të dokumentacionit për shërbimin mjekësor, si dhe krevat për kryerjen e vizitave e kontrolleve mjekësore me të arrestuarit/ ndaluarit. Për secilin person të arrestuar apo të ndaluar hapet kartela mjekësore, e cila plotësohet nga ndihmësmjeku në organikë të DVP Kukës, i cili ishte prezent në ditën e inspektimit.

Dhomat e sigurisë dhe dhomat e punës të stafit të policisë, ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, me ajrosje dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial (energji elektrike). Ambienti dhe dhomat e sigurisë ngrohen me kalorifer, nëpërmjet sistemit të kaldajave në periudhën e dimrit. Në fundin e korridorit në ambientin e sigurisë, ndodhet një ambient i përbashkët tualeti dhe dushi me ujë të ngrohtë (me bolier), që shërben për larjen e trupit sipas nevojave që paraqesin personat e ndaluar/arrestuar.

Hyrja e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitorohen nga 2 kamera përgjatë 24 orëve, pamjet e të cilave ruhen deri në 30 ditë. Mbajtja në vëzhgim e ambienteve kryhej nga salla operative e DVP Kukës, ndërsa pamjet filmike administrohen nga specialisti i IT në organikën e kësaj drejtorie.

Sipas informacionit në Komisaratin e Policisë në Kukës ishin ndaluar/arrestuar 11 shtetas të huaj. Për këto raste ishte zbatuar procedura e njoftimit të përfaqësive diplomatike të vendit të tyre, si dhe ishin pajisur me kartën e të drejtave në gjuhën e tyre amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë. Punonjësit e policisë, kishin asistuar shtetasit e huaj për sigurimin e avokatit mbrojtës dhe të një përkthyesi në gjuhën e tyre. Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë, ndodhej letra me të drejtat e shtetasve të ndaluar/arrestuar që ju privohet liria në mjediset e policisë, e cila ishte e përkthyer në 10 gjuhë të huaja kryesore.

Nga monitorimi që u bë zyra të oficerëve të policisë gjyqësore, në një zyrë nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat nuk kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe

⁵ Electronic recording of police interviewees (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

ruajtjen e provave materiale, në mënyrë që provat materiale të ruhen të futura në një qese të etiketuar ⁶.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Sipas parashikimeve në dispozitat e ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, çdo njësi policore ku ka dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur me regjistrat përkatës.

Theksojmë se, nga verifikimi i regjistrave dhe librave të shërbimit në Komisariatit e Policisë Kukës, u evidentua se regjistrat ishin të sekretuar dhe vulosur, sikurse përcaktohen në modelet tip të miratuar në procedurat standarde.

Konkretisht, në zyrën e informacionit ndodhej “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” sipas tipit “Model nr.1”, konform me procedurën standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por në çdo rast brenda afatit deri në 5 orë. Ndërkohë, përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatuam se rubrika e regjistrit mbi njoftimin e familjarëve nuk ishte e plotësuar në mënyrë korrekte, pasi në regjistër nuk ishte i shënuar emri i familjarit të njoftuar me numrin e telefonit përkatës, por ishte shënuar nga specialisti i policisë vetëm “Njoftuar familjari”, shënim i cili nuk identifikon familjarin i cili ka marrë dijeni⁷, kjo bazuar në procedurën standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku në pikën a.1.2 citohet se: “Në Regjistrin e Evidentimit të Personave të Shoqëruar duhen plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe

⁶ Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale “Vulosja e sendeve të sekuestruara”.

⁷ Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit të një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.

numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe ora e njoftimit”.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Në këtë komisarariat mbahej dhe regjistri me të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili gjithashtu ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë njëherësh për Komisarariatet e Kukës, Has dhe Tropojë, në varësi të DVP Kukës. Në procesverbalin e arrestimit apo ndalimit, ishte shënuar ora kur personat ishin mbajtur të shoqëruar në mjediset e policisë, pra në momentin kur atyre ju ishte privuar liria.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në këtë Komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në këtë institucion administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë muajit janar korrik të vitit 2025, kishte 5 të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5). Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe në disa gjuhë të huaja.

Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë, ndodheshin të gjithë regjistrat dhe librat e shërbimit që parashikohen në procedurën standarde si: - regjistri i evidentimit të personave të arrestuar/ndaluar; - regjistri marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore; - regjistri i takimeve të të arrestuarve/ndaluarve me mbrojtësit ligjorë (avokatë e kujdestarë), mbrojtësit e të drejtave të njeriut (OJQ e OJF), Avokatin e Popullit etj.; - regjistri i kërkesë/ankesave të personave të privuar nga liria; - regjistri i evidentimit të vizitave mjekësore që kryhen menjëherë pas arrestimit/ndalimit, gjatë kohës së qëndrimit të dhomat e sigurisë, në qendrat spitalore; - libri i marrjes, dorëzimit të shërbimit të sigurisë së brendshme dhe sigurisë së jashtme të dhomave të sigurisë; - fashikulli për administrimin e kopjeve të deklaratës për njohjen e të drejtave nga të arrestuarit/ndaluarit, me nënshkrimin e tyre; - lista e punonjësve të policisë që shërbejnë në dhomat e sigurisë dhe lista e personelit ndihmës teknik që lejohet të hyjnë në dhomat e sigurisë, të miratuara nga drejtori i policisë së vendore/shefi i komisarariatit të policisë; - libri i marrjes e dorëzimit

të shërbimit për sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve në qendrat spitalore; - regjistri i takimit të nënës me fëmijën për ushqyerjen me gji; - regjistri takimeve të personave të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, me pjesëtarë të familjes; - regjistri i sendeve personale të arrestuarve/ndaluarve.

Të gjithë librat e shërbimit e regjistrat ishin të regjistruar me numër fletësh në sekretari dhe të vulosur, dhe pas përfundimit të tyre ato dorëzoheshin po në sekretarinë e institucionit, për t'i ruajtur sipas afateve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Avokati i Popullit ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e mbikëqyrjes policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Kjo merr më shumë vlerë pasi ky komisarjat shërben edhe si ambient sigurie për komisarjatet e tjera që nuk kanë dhoma të tilla.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht në nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe në nenin 19, pika 7 e ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në momentin e inspektimit në ambientet e shoqërimit të Komisarjatit të Policisë Kukës, nuk ndodhej asnjë person në dhoma, ndërsa në ambientin e sigurisë ndodheshin 2 (dy) persona të ndaluar, të cilët nuk paraqitën ankesa.

U evidentua nga inspektimi se, personat e ndaluar/arrestuar, trajtohen me ushqim tre herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim⁸ që përgatitej në kuzhinën e përbashkët me IEVP Kukës, e cila ndodhet brenda territorit të komisarjatit të policisë Kukës.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, nga intervista me punonjësit e policisë, u evidentua se të ndaluarit/arrestuarit që dëshironin, u lejohej të predikonin ritet fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarit/arrestuarit furnizoheshin rregullisht me produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Personat e ndaluar, për të cilët gjykata ka lëshuar vendim të formës së prerë “arrest me burg”, transferoheshin menjëherë në ambientet e IEVP Kukës, që ndodhej në të njëjtën godinë me dhomat e sigurisë të Komisarjatit të Policisë Kukës.

⁸ Urdhëri i përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Kukës, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Gjithashtu, në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁹.

Një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe evidentimin e saktë të deklarimeve të të shoqëruarit apo ndaluarit, por edhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Kjo masë është në interes si të individëve për të menjanuar keqtrajtimin qofte fizik apo psikologjik nga punonjësit e policisë ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e punonjësit të policisë së shtetit, ashtu edhe të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

Nga biseda me drejtuesit e komisarlatit në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit janë të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut i cili ishte në organikë të DVP Kukës.

Intervistimi i të miturve, kryhej në ambient të veçantë i krijuar me donacion të UNICEF dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar në bashkëpunim me DPSH-në, në kuadër të Programit *“Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qënieve njerëzore në dhe nga Shqipëria” 2019-2022*.

Ky ambient ishte i kompletuar me orënditë e nevojshme si tavolina pune dhe kompjuter për punonjësit e policisë, si dhe karrige e kolltuqe për qëndrimin ulur të fëmijës, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës. Punonjësit e policisë që trajtonin rastet e të miturve në konflikt me ligjin, ishin strukturë më vete dhe të trajnuar për këtë qëllim. Nga

⁹ Electronic recording of police interview, fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

verifikimi i dokumentacionit u konstatua se ky ambient ishte përdorur në vijim për çdo rast të trajtuar.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në Komisaratin e Policisë Kukës, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 84/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Kreun VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit me personin e arrestuar nga grupi i inspektimit.

Në hyrje të ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë të Komisaratisë të Policisë Kukës, ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar. Grupi i inspektimit kërkoi informacion në lidhje me mënyrën e informimit të personave të shoqëruar me të drejtat e tyre, si dhe kërkoi kartën e të drejtave. Megjithatë nga informacioni rezultoi se, të shoqëruarit pajiseshin me kartën e të drejtave që në momentin e hyrjes në mjediset e policisë, nga punonjësi i informacionit nuk na u vu në dispozicion një kopje e kartës së të drejtave, çka tregon për neglizhencë të punonjësve të policisë në zbatimin e detyrave në këtë komisarariat, por edhe moszbatim të standardeve të vendosura, nisur dhe nga rekomandimet e Avokatit të Popullit.

E drejta për informim është një e drejtë themelore e shtetasve. Kjo e drejtë duhet të respektohet me rigorozitet edhe për personat e privuar nga liria në mjediset e policisë së shtetit. Nisur nga kjo e drejtë kushtetuese dhe e njohur me aktet ndërkombëtare, KPT (CPT) në vizitën e tij inspektuese në Shqipëri në vitin 2023, ka rekomanduar autoritetet shtetërore “Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit. Personave të arrestuar/ndaluar duhet t’u jepet dhe të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të fletës me të drejtat e tyre”¹⁰.

Ndërkohë, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson uljen e kohës së ndalimit të përkohshëm, në Ligjin e ri për Policinë e Shtetit nr.82/2024, i cili fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes, por në asnjë rast më shumë se 5 orë.

¹⁰ <https://ëëë.coe.int/en/ëëb/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-cpt-publishes-report-on-albania>

Personat e ndaluar apo të arrestuar pajiseshin me setin e dokumenteve (urdhri për ndalimin/arrestimin në flagrancë të personit, procesverbali i dorëzimit të sendeve personale), midis tyre dhe letrën e të drejtave, nga oficeri i policisë gjyqësore, në momentin e komunikimit të masës së arrestit dhe kalimin e tyre për në dhomat e sigurisë.

Sipas informacionit, punonjësit e policisë u bënë të ditur personave të ndaluar/arrestuar, të drejtën dhe detyrimin për t'u mbrojtur me avokat mbrojtës gjatë procesit të marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

Të ndaluarit/arrestuarit që kërkonin mbrojtjen me avokat u ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me avokatët mbrojtës në bazë të listës së afishuar në ambientin e sigurisë. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit, nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht të caktuar nga prokurori i çështjes, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu nga mbikëqyrja e fashikullit të dosjes për persona të shoqëruar ndaluar/arrestuar, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhorë, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Koha më e zgjatur në marrjen kontakt të personit të privimit lirisë me avokatin ishte afërsisht 3 orë.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, ose të zgjedhur nga familjarët e tyre, si dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës. Takimet me avokatët mbrojtës, kryheshin në dhomën e improvizuar në ambientin e sigurisë, sa herë që kërkohej nga personat e ndaluar/arrestuar.

Vizita mjekësore me personat e ndaluar/arrestuar dhe ofrimi i ndihmës mjekësore, të parashikuara në procedurat standarde, kryhej rregullisht nga mjeku në dhomën e tij të vizitave. Mjeku ishte në organikë të DVP Kukës dhe i punësuar me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet për vizitë te mjeku specialist dhe mjekimet, regjistroheshin në librin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë të këtij komisariati. Në rastet e urgjencave, kur kërkohej ndërhyrje e mjekëve të specializuar, personat e sëmurë shoqëroheshin menjëherë për në Spitalin Rajonal Kukës.

Vizitat mjekësore kryheshin nga mjeku i DVP Kukës, kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata dërgoheshin edhe në Spitalin Rajonal Kukës.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien*

në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Kukës, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe mos ndërtohen komisarlate që nuk janë në përputhje me *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë së Shtetit”*.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisarlatit.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurave standarde.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për për zëvendësimin e portës me profil hekuri, me dyer me profil prej materiali druri në ambientin e korridorit të shoqërimit sipas parashikimeve kreu VI pika 4.e.6.1, e.6.2, në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohje/ftohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen e dhomës së shoqërimit me tavolina të fiksuara në dysheme dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda ambientit të dhomës së shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Kukës

8. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.
9. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
10. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së avokatëve mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihem në dijeni brenda afatit **30 ditë** sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI
Mekanizmi Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)

Ahmet PRENÇI
dv